



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0363**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “CAPITAL X FET” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” me numër të prokurimit 632-23-14124-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”, më 10/07/2024, mori këtë:

### Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e CAPITAL X FET SH.P.K. me nr. 2024/0363, e datës 26/04/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale”, me numër të prokurimit 632-23-14124-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”.

2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E GJAKOVËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.12.2023, “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” me numër të prokurimit 632-23-14124-2-1-1, ndërsa me datën 08.04.2024 ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues e ka shpërblyer me kontratë

OE "Selmans Network" SHPK.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 163,000.00 €.

Me 12.04.2024, OE "CAPITAL X FET" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 17.04.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26/04/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "CAPITAL X FET" SH.P.K., me nr. 2024/0363 lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale "më numër të prokurimit 632-23-14124-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim e ka refuzuar si të pa bazuar me arsyetimin se: "Operatori Ekonomik " CAPITAL X FET \* SH.P.K. me de.12.04.2024, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale, Nr. i prokurimit- 632-24-14124-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-23-199-211.Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me date 17.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar Deklaratën nën betim siç duhet sepse nuk ka shënuar emrin dhe numrin e brendshëm, të aktivitetit të prokurimit, nuk qëndron, ngase një gjë e tillë nuk kërkohet në FDT e as në LPP-ë

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar listën e projekteve në tri vitet e fundit, por le kontrata dhe referenca me OE privat nuk ka ofruar dëshmi të transaksioneve bankare që ka realizuar kontratën, nuk qëndron , sepse ky operator i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues (K Deçan, Arkivës Kosovës, Spital në qytetin e Ferizajt)

Pretendimi juaj se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka parapare pushim vjetore për 20 punëtorët nuk qëndron, sepse i njëjti ka prezantuar një deklaratë të nënshkruar dhe se vulosur ku deklaroi se "se të gjithë të punësuarit do të paguaj me rregull dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit për të gjitha kategoritë dhe pozicionet e përcaktuara në dosjen duke përfshirë pagën trustin dhe obligimet tjera që dalin nga marrëdhënia e punës.

Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate në analizën financiare nuk ka parapare pushimet vetore të punëtorëve nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues ka kërkuar analize financiare në të cilën parashihen shpenzimet për pagat e punëtorëve”.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “CAPITAL X FET” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: pretendimet ankimore të OE ankues:

Me e datën 08.04.2024 përmes platformës elektronike kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK me datë 12.04.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim në bazë të LPP.

Me datën 17.04.2024 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim , në bazë të LPP në fuqi parashtrime ankese pran organit shqyrtues të prokurimit

AK ka shpallur fitues për procedurën në fjalë OE “Slemans Network” shpk, pas analizimit të dokumenteve ka vërejtur se AK ka bërë shkeljet të LPP në momentin që ka shpallur fitues OE në fjalë.

OE “Slemans Network” shpk nuk ka plotësuar deklaratën në betim siç kërkohet në LPP , ku në LPP citohet se për secilin procedurë të prokurimit OE është i obliguar që lartë ta shënojë emrin e procedurës dhe nr e prokurimit dhe nr e brendshëm , OE nuk e ka plotësuar fare .

OE “Slemans Network” shpk e ka prezantuar listën e projekteve në tri vitet e fundit , por të kontrata dhe referenca me OE privat nuk ka ofruar dëshmi transaksione bankare që i ka realizuar kontratën por vetëm referencë me schafferberger jr gmbh pa ndonjë dëshmi tjetër për realizimin e kontratës.

OE “Slemans Network” shpk në analiza financiare të dorëzuar nuk i parapare pushime vjetore për 20 të punësuarit , ku në FDT citohet : operatori ekonomik duhet të deklarohet se punëtorëve do ju paguaj pagën minimale bruto 400,00 euro si mbas ligjit të punës nr.03 l-212 si dhe ATK-së.

Si dhe kërkohet operatori ekonomik duhet të dorëzojë analizën financiare në të cilën përfshihen pagat e punëtorëve për numrin e kërkuar, shpenzimet e materialit dhe të detyrimet tatimore i kur marrim për baze

ligjin e punës 03-l-212 dhe ATK , secili i punësuar ka te drejtën e pushim vjetor sipas ligjit ne fuqi .

OE “Slemans Network” shpk duke mos llogaritur pushime vjetore fare ka ofertuar me çmimi me te lire , por njëkohësisht nuk ka përmbushure kërkesat e FDT , dhe analiza financiare e tij nuk plotësoni kriteret për dhenje te kontrate.

Te gjithë OE pjesëmarrës te tjerë bashke edhe me neve si ankues ne këtë rast për ne këtë procedure te prokurimit përveç OE “Slemans Network” shpk ne analizën financiare te dorëzuar kane parapare pushimet vjetore sipas ligjit te punës ne fuqi 03-l-212 dhe ATK-se, përveç OE “Slemans Network” shpk ku detyrimisht ka dale si OE me i liri por jo edhe i përgjegjshëm, duke mos përmbushur kriterin e FDT qe ne analizë financiare te përfshihen gjitha shpenzimet, kur dihet qe pushimet vjetore janë te detyrueshme dhe obligohet secili OE me ligj ti mbuloje dhe ne këtë rast ti zëvendësoj punëtorë kur kërkojnë pushim .

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, dhe 60 të LPP-së. Duke propozuar qe të aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Capital X Fet” shpk dhe lënda kthehet në rivlerësim dhe Autoritet Kontraktues te beje vlerësim te drejte dhe te shpallemi ne fitues si OE i përgjegjshëm me çmimi me të lirë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26/04/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0363/24, ndërsa me datë 03/05/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0363 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh pretendimet ankimore, analizimin e ofertave dhe analizimin e analizave financiare mbi pagën ne cilësinë e ekspertit shqyrtues rekomandoj PSH.OSHP qe te refuzoj ankesën e operatorit ekonomik si te pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK për dhënie te kontratës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK është pajtuar me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “CAPITAL X FET” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0363 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimore nr.1: OE “Slemans Network” shpk nuk ka plotësuar deklaratën nën betim siç kërkohet në LPP, ku në LPP citohet se për secilin procedurë të prokurimit OE është i obliguar që lartë ta shënojë emrin e procedurës dhe nr. e prokurimit dhe nr. e brendshëm, OE nuk e ka plotësuar fare.

Përgjigja e Ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimore nr.1: Operatori ekonomik i rekomanduar ka plotësuar dhe dorëzuar Deklaratën nën betim konform Nenit 65 të LPP, andaj në bazë të kësaj konstatojmë se pretendimi ankimore është i pa bazuar, pasi që operatorit ekonomik ofertues ka Deklaratën nën betim sipas Aneksit nr.2 të DT-së.

Pretendimi ankimore nr.2: OE Slemans Network shpk e ka prezantuar listën e projekteve në tri vitet e fundit, por të kontrata dhe referenca me OE privat nuk ka ofruar dëshmi transaksione bankare që i ka realizuar kontratën por vetëm referencë me schafferberger jr gmbh pa ndonjë dëshmi tjetër për realizimin e kontratës.

Përgjigja e Ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimore nr.2: Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka kërkuar si në vijim:

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit ku AK ka kërkuar që OE duhet të ketë 240,000 euro kontrata, referenca të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit që dmth vitet (2021, 2022 dhe 2023) operatori ekonomik i rekomanduar konform kësaj ka prezantuar një listë me kontrata dhe referenca ku ka kontrata dhe referenca të ngjashme të përfunduara (brenda tri viteve të fundit 2021, 2022 dhe 2023) në autoritete kontraktuese të ndryshme dhe vlera e tyre arri prej - 305,487.32 euro dhe kjo shumë përmbush kriterin ligjor të kërkuar në dosjen e tenderit andaj pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 3: OE “Slemans Network” shpk në analizën financiare të dorëzuar nuk i parapare pushime vjetore për 20 të punësuarit, ku në FDT citohet. OE Slemans network shpk duke mos llogaritur pushime vjetore fare ka ofertuar me çmimi me të lirë, por njëkohësisht nuk ka përmbushur kërkesat e FDT, dhe analiza financiare e tij nuk plotësoni kriteret për dhënie të kontrate.

Përgjigja e Ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimore nr.3:Autoriteti Kontraktues ne dosjen e tenderit ka kërkuar si vijon:

Bazuar në këtë për kërkesën Deklaratë të mbi pagën dhe kontributet, pushimet vjetore dhe detyrimet tjera tatimore operatori ekonomik i rekomanduar ka prezantuar ne ofertë Deklaratën mbi pagën 400,00 euro

Të njëjtit kanë prezantuar edhe Analizën financiare si më poshtë:

Bazuar ne pretendimin ankimore te ngritur nga OE ankuese ne cilësinë e ekspertit shqyrtues kam analizuar me kujdes llogaritjen e Analizës financiare te prezantuar nga ana e OE te rekomanduar dhe konkludoj si ne vijim:

Operatori ekonomik ankues pretendim ankimore bazë ka mos kalkulimin e pagës për pushimet vjetore te 20 punëtoreve.

Operatori ekonomik i rekomanduar ne analizen e tyre financiare kanë ofertuar me shumën prej 118,944.00 euro për pagesat e 20 punëtoreve për 12 muaj.

Ne dosjen e tenderit, Aneksin nr. 1 AK ka theksuar se paga baze dhe te jetë prej 400 euro bruto me te gjitha kontributet sipas Ligjit te punës 03/L-212.

Duke pasur parasysh Nenin 32 paragrafin 3 te Ligjit te Punës nr.03/L-212 cekët; 3. I punësuari i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje së paku prej tridhjetë (30) ditësh pune, për vitin kalendarik.

Andaj ne baze te kësaj ne cilësinë e ekspertit shqyrtues fillimisht duhet llogarisim pagën për 11 muaj te punës më pasë për 1 muaj te pushimit vjetore(apo 30 ditë) si pas ligjit. Se cili nëpunës sipas Ligjit te punës 03/L-212 ka te drejtën e pushimit 30 dite pune kalendarike(me pagesë) brenda 12 muajve që dmth secili punëtorë punon plotë 11 muaj dhe pushon 30 ditë.

Analiza financiare e kalkuluar sipas pagës se kërkuar për 20 punëtorë për 11 muaj punë prezentë.

Analiza financiare kalkuluar sipas pagesa se kërkuar për 20 punëtorë për 1 muaj (30 ditë pushim) brenda 12 muajve.

Totali i mbulimit të shpenzimit të pagave sipas kërkesës së AK me pagën prej 400 euro Bruto me të gjitha shpenzimet ligjore mbi pagën për 20 punëtorë për 12 muaj përfshirë këtu edhe pushimin sipas ligjit është gjithsejtë - 118,944.00 euro me TVSH dhe të gjitha shpenzimet tjera apo obligimet mbi pagën. Diferenca e ofertave mes operatorëve ekonomik, nuk diktohet në këtë rast nga oferta në pagë pasi që të gjitha kanë po thuajse të njëjtën analizë financiare lidhur me pagën, por ofertat financiare diktohen nga oferta apo çmimi në shpenzimet e materialit dhe uniformes dhe kjo bën dallimin final mes operatorëve ekonomik ofertues në këtë aktivitet.

Pasur parasysh kalkulimin financiar konstatohet se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar lidhur me pagën është konform kërkesës së AK dhe e njëjta mbulon shpenzimin e pagave për 20 punëtorët e kërkuar dhe se pretendimi ankimore se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka llogaritur shpenzimet e pushimeve për 20 punëtorët është i pa bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “CAPITAL X FET” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “CAPITAL X FET” SH.P.K., janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke

marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues duke u bazuar në rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E GJAKOVËS” të datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” me nr. të prokurimit: 632-23-14124-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - CAPITAL X FET SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: